



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

SHCALLJE PËR NËNPUNËS CIVILË LËVIZJE PARALELE, DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Specialist i Financës në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve, në Drejtorinë e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve të Institucionit të Avokatit të Popullit

Në zbatim të nenit 26 të ligjit nr.152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar si dhe të Kreut II, dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.243, datë 18.3.2015 "Për Pranimin, Lëvizjen Paralele, Periudhën e Provës dhe Emërimin në Kategorinë Ekzekutive", Institucioni i Avokatit të Popullit shpall procedurat e Lëvizjes Paralele dhe Pranimit nga Jashtë në Shërbimin Civil për pozicionin:

- **1 (një) "Specialist i Financës" në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve, në Drejtorinë e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve - kategoria e pagës III-b.**

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se pozicioni është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil.

PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!

Afati për dorëzimin e Dokumenteve për:

LËVIZJE PARALELE

29.05.2023

Afati për dorëzimin e Dokumenteve për:

PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL

02.06.2023

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

Implementimi dhe zbatimi i procedurave të lidhura me veprimet që gjenerojnë shpenzime dhe /ose të ardhura dhe garantimi i përputhshmërisë me ligjin:

1. Merr pjesë në hartimin e buxhetit vjetor të Institucionit, e zbaton atë dhe të gjitha veprimet financiare;
2. Organizon alokimin e fondeve;
3. Kryen regjistrimin dhe rishpërndarjen e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas Ligjit brenda vitit financiar.
4. Ndjek dhe llogarit të gjithë shpenzimet e Institucionit sipas zërave të buxhetit;
5. Mban Inventaret;
6. Kontrollon magazinën dhe lëvizjeve të vlerave monetare dhe materialeve në përputhje me dokumentacionin perkatës dhe me legjislacionin në fuqi.
7. Ndhmon në përgatitjen e raporteve periodike për ecurinë e punës në njësinë organizative, në Institucion, me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë etj, në lidhje me fushat që mbulon;
8. Raporton për rezultatet e ekzekutimit të buxhetit tek eprori direkt;
9. Koordinon punën me Ministrinë e Financës etj;
10. Ndjek dhe zbaton çdo detyre tjetër të caktuar nga eprorët, me korrektësi dhe brenda afateve.

1 LËVIZJA PARALELE

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jenë nëpunës civil të konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria III-b; IV-a; IV-b);
- b- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- c- Të kenë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor”, “Master Shkencor apo Profesional” në Shkencat Ekonomike, edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë.
(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
- b) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 (tre) vite pune në Administratën Publike.

- c) Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.
- d) Të njohë programet bazë të kompjuterit (të vërtetuar me çertifikatë).
- e) Të zotërojnë mirë gjuhën angleze ose një gjuhë të BE-së.

1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Letër motivimi për aplikimin për vendin vakant si dhe një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-mail;
- b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>;
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j- Aktin e konfirmimit të statusit të nëpunësit civil përfshirë dhe kategorinë e pagës;
- k- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucionin e Avokatit të Popullit, në adresën: Bulevardi “Zhan’ Dark” nr.2, Tiranë, brenda datës 29.05.2023.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për skualifikim të kandidatit.

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 31.05.2023, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Avokatit të Popullit do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe stendat e informimit me publikun të institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore brenda 3 (tre) ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës dhe njoftimit individual. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar;
2. Njohuritë mbi Ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar;
3. Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar;
4. Njohuritë mbi Ligjin nr.9367 datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit”;
5. Njohuritë mbi Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
6. Njohuritë mbi Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
7. Njohuritë mbi Ligjin nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”;
8. Njohuritë mbi Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
9. Njohuritë mbi Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
10. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me Dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen 20 pikë për përvojën, 10 pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe 10 pikë për certifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i certifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **40 pikë**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”, të Departamentit të Administratës Publike [www.dap.gov.al](http://dap.gov.al).

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Avokati i Popullit për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët për rezultatin e pikëve, paraqiten në Komitetin e Pranimit për Lëvizjen Paralele brenda 3 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 5 ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të procesit të ankimimit, në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit (www.avokatipopullit.gov.al), do të shpallet lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve), në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe në stendën e informimit të publikut të institucionit. Kandidat fitues është ai që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marre të paktën 70 pikë (70% të pikëve).

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të Shërbimit Civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të Ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

- f) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit “Bachelor”, “Master Shkencor apo Profesional” në Shkencat Ekonomike, edhe diploma e nivelit “Bachelor” duhet të jetë në të njëjtën fushë.
(Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi).
2. Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 (tre) vite pune në Administratën Publike.
3. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grupe.
4. Të njohë programet bazë të kompjuterit (të vërtetuar me certifikatë).
5. Të zotërojnë mirë gjuhën angleze ose një gjuhë të BE-së.

2.2 DOKUMENTECIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë Dokumentet si më poshtë:

- a- Letër motivimi për aplikimin për vendin vakant si dhe një numër kontakti dhe adresën e plotë të vendbanimit të shoqëruar me një adresë aktive e-mail;
- b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:
<http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>;
- c- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore;
- h- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- i- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- j- Aktin e konfirmimit të statusit të nëpunësit civil përfshirë dhe kategorinë e pagës;
- k- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucionin e Avokatit të Popullit, në adresën: Bulevardi “Zhan’ Dark” nr.2, Tiranë, brenda datës 02.06.2023.

Mosparaqitja e dokumentacionit të kërkuar përbën shkak për skualifikim të kandidatit.

2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 12.06.2023, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Avokatit të Popullit do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe standat e informimit me publikun të institucionit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e pranimit nga jashtë shërbimit civil dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista dhe testimi me shkrim.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit nga jashtë shërbimit civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore brënda **5 (pesë)** ditëve kalendarike nga data e shpalljes së listës dhe njoftimit individual. Ankuesi merr përgjigje brënda **5 (pesë)** ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

2.4

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë mbi Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar;
2. Njohuritë mbi Ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar;
3. Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për Njësirin Civil”, i ndryshuar;
4. Njohuritë mbi Ligjin nr.9367 datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit”;
5. Njohuritë mbi Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
6. Njohuritë mbi Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
7. Njohuritë mbi Ligjin nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
8. Njohuritë mbi Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
9. Njohuritë mbi Ligjin nr.9643 datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;
10. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.5

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a-** Vlerësimin me shkrim, deri në **40 pikë**;
- b-** Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në **40 pikë**;
- c-** Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në **20 pikë**.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin Nr. 2, datë 27.03.2015, “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”, të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

<http://dap.gov.al/2014-03-21-12-52-44/udhezime/426-udhezim-nr-2-date-27-03-2015>

2.6

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga Avokati i Popullit për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

Ankesat nga kandidatët për rezultatin e pikëve, paraqiten pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore brenda **3** ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda **5** ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit të ankimit.

Në përfundim të procesit të ankimimit, në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit (www.avokatipopullit.gov.al), do të shpallet lista e fituesve me të paktën 70 pikë (70% të pikëve), në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe në stendën e informimit të publikut të institucionit. Kandidat fitues është ai që renditet i pari ndër kandidatët që kanë marrë të paktën 70 pikë (70% të pikëve).